



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.401/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit –kundër të paditurit B. B. nga fshati ..., Komuna e I., i përfaqësuar nga të autorizuarit pranë Zyrës së Avokatisë GHG- Granit Curri, Egzonis Hajdari dhe Skender Gojani nga P., kundër të paditurës – kundër paditëses B. S. nga fshati ..., Komuna e I., e përfaqësuar nga avokatja Sh. M. - F. nga Istogu, për shkak të kontaktit me fëmijën, besimin e fëmijës dhe alimentacionit, duke vendosur sipas revizionit të paditurës – kundër paditëses të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7053/22 datë 7.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.09.2024, mori këtë,

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurës – kundër paditëses B. S. nga fshati C., Komuna e I., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7053/22 datë 7.06.2024.

### A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7053/22 të dt.7.06.2024 është hedhur ankesa e të paditurës- kundër paditëses B. S., nga fshati ..., Komuna e I., e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog C.nr.367/21 dt.4.08.2022, si e pas afatshme.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes qenësore të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të aprovohet revizioni, të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.7053/22 dt.7.06.2024 apo aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog C.nr.367/21 dt.4.08.2022, të goditura në pjesën I, II, IV në kuptim të nenit 224 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktvendimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 230 të LPK, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të revizionit ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës – kundër paditëses është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog, lidhur me çështjen juridike të sipër përmendur, ka marrë aktgjykimin C.nr.367/21 dt.4.08.2022, me të cilin ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit – kundër të paditurit B. B. nga fshati ..., Komuna e I., dhe ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kundër padinë e të paditurës – kundër paditëses B. S. nga fshati ..., Komuna e I., pastaj ka vendosur si në pjesën I, II, III, IV dhe V të dispozitivit të aktgjyimit të saj. Ndërsa, lidhur me ankesën e të paditurës – kundër paditëses, të paraqitur kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë C.nr.367/21 dt.4.08.2022, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin e vet Ac.nr.7053/22 dt.7.06.2024, e ka hedhur ankesën e të paditurës – kundër paditëses B. S., si të pas afatshme. Kështu sepse, siç ka konstatuar gjykata e shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vërtetohet se palëve ndërgjyqëse iu është dërguar nga një kopje e aktgjyimit C.nr.367/21 dt.4.08.2022 dhe atë të paditurës – kundër paditëses i është dorëzuar më dt.12.09.2022, siç shihet nga fletë kthesa e gjykatës, ndërsa, ankesën pala e paditur e ka dorëzuar në Postën e Kosovës më dt.30.09.2022, e cila vërtetohet nga vula e pranimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Istog. Nga momenti i pranimit të aktgjyimit C.nr.367/21 dt.4.08.2022 e deri në dorëzimin në Postën e Kosovës më dt.30.09.2022, kanë kaluar 18 ditë, ndërsa, afati për paraqitjen e ankesës është 15 ditë dhe si ditë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 27.09.2022, që do të thotë se ankesa është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor, prej 15 ditësh të paraparë me nenin 176 të LPK-së, ndaj, sipas nenit 196 të këtij ligji, e njëjta ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të saj, të sipër përmendur.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, kjo gjykatë, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të saj, përkatësisht, konsideron se gjykatat e shkallës së dytë, me zbatimin e tillë dispozitave të procedurës kontestimore, ka vendosur drejtë kur ka gjetur se ankesa e të paditurës – kundër paditëses është e pas afatshme dhe si e tillë e njëjta është hedhur. Aktvendimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendohet në revizion e as me shkelje tjera, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë, drejt i ka zbatuar dispozitat e nenit 176 ( nenit 186 ) dhe të nenit 196 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilat, veç tjerash, përcaktohet se “ Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të pa lejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”, përkatësisht, “ Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj “, sikundër edhe është rasti konkret civil juridik. Kështu, nga se sikundër rrjedh nga shkresat e lëndës, e paditura- kundër paditësjë vërtetë e ka pranuar aktgjykimin C.nr.367/21 dt.4.08.2022, më dt.12.09.2022, siç vërtetohet nga flet kthesa përkatëse (e cila gjendet në shkresat e lëndës), kurse, kundër këtij aktgjykimi e paditura ka paraqitur ankesë më dt.30.09.2022, ( në postën e Kosovës-Rekomande-....) që d. m. th. ankesën e ka parashtruar tri ditë pas skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës, përkatësisht, ditën e 18-të. Në kontekstin e mësipërm, kur jemi këtu, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 176.1 të LPK-së, përcaktohet veç tjerash, se “ Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër.....”. Ndërkohë që, në mbështetje të dispozitës së sipër përmendur, rezulton se afati prej 15 ditësh, është afat ligjor dhe se nuk mund të ndryshohet nga gjykata, si dhe u mor vesh as nga palët ndërgjyqëse, ndaj, kjo ka bërë që gjykata e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitave të sipër përmendura të LPK-së, të vendos si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Nga këtu dhe nga arsyet e sipër përmendura, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndrojnë thëniet e revizionit për shkeljet e pretenduara të dispozitave procedurale dhe materiale.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 230 të LPK,  
u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.401/2024 datë 24.09.2024

Kryetari i kolegjit,  
Mr.sc.Muhamet Rexha